


*Policy Brief* Nr. 2

Dhjetor 2006

DREJT  
INTEGRIMIT  
EUROPIAN  
ME NJË  
SHQIPËRI NË  
NGËRÇ



## PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....	3
2. Bashkëpunimi dhe konsensusi politik i munguar.....	4
3. Nevoja për një qeverisje vizionare dhe ndërtimi i një administrate publike moderne.....	5
4. Sfidat e ndërtimit të një sistemi gjyqësor eficient në mungesë të një standardi të unifikuar europian.....	7
5. Politika antikorrupsion nuk duhet kthyer qëllim në vetvete.....	8
6. Konkurrueshmëria dhe rritja e qëndrueshme ekonomike.....	9
7. A reflektohen prioritetet e MSA-së në zërat buxhetorë?.....	11
8. Konkluzione.....	17
Referenca.....	19

## 1. HYRJE

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), Shqipëria kaloi në një fazë më të avancuar të marrëdhënieve kontraktuale me Bashkimin Europian, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt etapave të mëtejshme në procesin e integritimit europian. MSA-ja reflekton të ashtuquajturat kritere të Kopenhagenit<sup>1</sup> dhe të Madridit për anëtarësimin e një vendi në BE, të cilat gjenden të sanksionuara edhe në Traktatin e Bashkimit Europian<sup>2</sup>.

Nënshkrimi i MSA-së gabimisht u interpretua si një fitore qeveritare, megjithëse procesi që i parapriu nënshkrimit ishte produkt i një punë disavjeçare që nisi në vitin 1991 me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike Shqipëri-BE. Për këtë arsye, Raporti Vjetor i Komisionit Europian, i publikuar më 8 nëntor 2006<sup>3</sup>, dhe Strategjia e Zgjerimit<sup>4</sup> duheshin lexuar në frymën e vazhimit të një dialogu që intensifikohet në mënyrë të natyrshme, me konstatime dhe sugjerime kritike. Në të kundërt, i ashtuquajturit *ambiguitet konstruktiv* i Komisionit Europian, edhe kësaj radhe nuk i shpëtoi dot leximeve bardh e zi dhe interpretimeve pro apo kundër të asaj që pozita apo opozita quajnë fitore, regres apo *status quo*.

Përballë vendosmërisë europiane, shprehur në Strategjinë e Zgjerimit se, pas anëtarësimin të Bullgarisë dhe Rumanisë, procesi i zgjerimit do të mund të vazhdojë vetëm pas rregullimeve institucionale brenda BE-së, Shqipëria duhet t'i vendosë reformat e kërkuara nga Brukseli, si prioritete të politikës së saj. Në vazhden e Strategjisë së Zgjerimit, konkluzionet e Këshillit Europian të 14-15 Dhjetorit 2006 përcaktojnë qartë se: BE nuk do të paracaktojë një datë të ardhshme për zgjerim, përpara se vendi kandidat të përfundojë procesin e negociimit për anëtarësim<sup>5</sup>, sikundër bëri në rastin e Rumanisë dhe Bullgarisë.

Strategjia e Zgjerimit thotë se, zbatimi me rigorozitet i detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja përbën garancinë e vetme për kalimin në fazat e tjera që do t'i paraprijnë anëtarësimin të Shqipërisë në BE. Dy muaj pas publikimit të Raportit të Komisionit Europian dhe Strategjisë së Zgjerimit, ky studim trajton elementet thelbësore të tyre, duke analizuar faktin se në ç'masë rekomandimet e prodhuara në këto dokumente të rëndësishme, reflektohen në prioritete dhe aksione konkrete të politikës shqiptare.

---

<sup>1</sup> Në vitin 1993, Këshilli Europian i Kopenhagenit miratoi disa kritere që duhet të plotësojnë shtetet me qëllim anëtarësimin e tyre në BE. Këto kritere përfshijnë: kriteri politik që nënkupton stabilitetin institucional, funksionimin e demokracisë, sundimin e së drejtës, respektimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave; kriteri ekonomik që nënkupton funksionimin e një ekonomie tregu të aftë për t'i bërë ballë konkurrencës; aftësia për të pranuar dhe zbatuar *acquis communautaire* që nënkupton harmonizimin e legjislacionit vendas me atë të BE-së. Këto kritere u përforcuan në Këshillin Europian të Madridit në vitin 1995, i cili vuri theksin tek strukturat administrative të nevojshme për zbatimin e *acquis communautaire*.

<sup>2</sup> Shih, Nenin 49 në bashkëveprim me Nenin 6 (1) të Traktatit të BE-së.

<sup>3</sup> Shih, Report of the Commission of the European Communities, COM (2006) 694 final, Brussels, 8.11.2006.

<sup>4</sup> Shih, Enlargement Strategy and Main Challenges 2006-2007, COM (2006) 649, Brussels, 8.11.2006.

<sup>5</sup> Shih, më specifikisht paragrafin 7 të Konkluzioneve të Këshillit Europian të datës 14-15 Dhjetor 2006.

## 2. BASHKËPUNIMI DHE KONSENSUSI POLITIK I MUNGUAR

Opinionit publik europian shpesh i serviret fakti se në Shqipëri, në dallim nga vendet e tjera të rajonit, nuk ekziston asnjë grupim politik, qoftë edhe perefierik, që të kundërshtojë procesin e integritimit euroatlantik. Por, a mjafton kjo për të jetësuar ëndrrën europiane të shqiptarëve? Natyrisht që jo! Konsensusi politik duhet zhvilluar përmes një bashkëpunimi konkret midis mazhorancës dhe minorancës, në lidhje me sfidat kryesore me të cilat përballet zhvillimi dhe transformimi i vendit, sfida thelbësore këto për integritimin europian.

Në këtë kontekst duhet kuptuar vlerësimi i Raportit të Komisionit Europian për rolin e Kuvendit si institucioni qendror i një demokracie kushtetuese, fakt që u tregua edhe në dorëzimin e Raportit për herë të parë në Kuvendin e Shqipërisë. Në të njëjtën kohë, Raporti nuk nguron të theksojë faktin se puna e Kuvendit përballet me mangësi teknike dhe administrative, me një buxhet të kufizuar që nuk fokusohet në mënyrë të qëndrueshme mbi detyrat thelbësore të Kuvendit si dhe mbi probleme që hasen në procedurat e pajisjet e votimit që nuk garantojnë rezultate transparente dhe të pakontestueshme.

Sipas Raportit, ndërhyrjet e Gjykatës Kushtetuese dhe të Presidentit të Republikës, kanë qenë të duhura dhe efikase. Në fakt, ndërhyrjet e Gjykatës Kushtetuese dhe ushtrimi i vetos presidenciale ndaj një pjesë të konsiderueshme të iniciativave të mazhorancës parlamentare (që janë justifikuar nga kjo e fundit si *raison d'être*), kanë vënë në pikëpyetje efektivitetin e Kuvendit. Vendimi i fundit i Gjykatës Kushtetuese, i cili shpalli antikushtetues dispozitat ligjore mbi bazën e të cilave Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë vendosi të prishë mbikalimin tek “Zogu i Zi”, ngre edhe një pyetje më të ndjeshme siç është ajo e kushtetueshmërisë dhe e ligjshmërisë në ushtrimin e autoritetit publik, sikundër përballet me qytetarëve shqiptarë me pasojat financiare që lidhen ngushtë me këtë vendimarrje<sup>6</sup>.

Raporti thekson se: “*Shqipëria duhet të tregojë se ka kapacitetet për të arritur bashkëpunim politik pa ndërhyrjen e jashtme*”. Por, dy muaj pas publikimit të këtij dokumenti dhe pas premtimit të bujshëm për miratimin e një rezolute në Kuvendin e Shqipërisë për kthimin e rekomandimeve të BE-së në veprime konkrete si dhe, një muaj pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Përkohshme, vështirë të thuhet se klasa politike, e ka konceptuar integritimin europian si një proces rreth të cilit mund të bashkohet, në funksion të transformimit dhe zhvillimit të vendit drejt standardeve europiane.

Skena politike shqiptare në prag të një procesi zgjedhor vendor që konsiderohet testi i radhës i një vendi tashmë të asociuar në BE, vazhdon të dominohet nga tensioni, konfliktualiteti dhe partikularizmi, i cili qendërzohet tek retorika populiste, raporti i deformuar Qeveri-Kuvend-President-Prokuror i Përgjithshëm-sistemi gjyqësor, reforma e munguar zgjedhore, që duhet ta kishte themelin në përfaqësimin politik dhe në mosdeformimin e vullnetit popullor, si dhe tek raporti i munguar midis mazhorancës dhe minorancës parlamentare, qeverisë, shoqërisë civile dhe grupeve të biznesit.

---

<sup>6</sup> Shih, Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 29, datë 21.12.2006.

### 3. NEVOJA PËR NJË QEVERISJE VIZIONARE DHE NDËRTIMI I NJË ADMINISTRATE PUBLIKE MODERNE


Qeverisja luan rolin thelbësor në procesin e afrimit të vendit me Bashkimin Europian, megjithatë ajo nuk është aktorja e vetme në këtë proces. Për të garantuar suksesin e këtij procesi afatgjatë, përpos të tjerash, qeverisjes i duhet të ndërtojë ura komunikimi dhe të përfshijë në vendimarrje opozitën, grupet e interesit, komunitete të ndryshme dhe shoqërinë civile. Vetëm në këtë mënyrë procesi i integritit europian, që në të vërtetë nuk është gjë tjetër veçse transformimi dhe zhvillimi i vendit drejt standardeve europiane, do të jetë më afër nevojave të përditshme të qytetarëve.

Në këtë kuadër, Raporti i Komisionit Europian nënvizon përpjekjet e qeverisë për të përcaktuar një kosto për procesin e integritit, për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim, si dhe për nisjen e 23 strategjive sektoriale dhe 10 strategjive të ndërthurura. Mirëpo Raporti nuk analizon realizmin, vërtetësinë dhe risitë që do të sjellë ky proces në raport me procesin e buxhetimit, pasi gjatë këtyre viteve Shqipëria nuk ka vuajtur nga mungesa e dokumenteve strategjike, por nga mungesa e vullnetit për t'i zbatuar ato në praktikë.

Hartimi dhe zbatimi i këtyre dokumenteve në praktikë bëhet edhe më i vështirë në rast se do t'i referohemi konstatimit tronditës të Raportit se, procesi i ristrukturimit të administratës publike ka sjellë reduktimin dhe ndërprerjen e fuqizimit të kapaciteteve administrative. Në fakt është e vështirë të vendosësh në balancë kërkesat që burojnë nga procesi i integritit europian, për një administratë gjithnjë e më të fortë dhe efikase me qeverisjen në dietë. Por është edhe më e vështirë të masësh vullnetin politik të një qeverie për të kryer reformat në funksion të europianizimit të vendit, nëse vullneti i qeverisjes nuk përqendrohet tek forcimi i administratës publike, në respekt të parimeve kushtetuese dhe ligjit mbi bazën e të cilit, duhet të funksionojë administrata publike, si ADN-ja e një shoqërie moderne.

Megjithatë, kjo është vetëm njëra anë e medaljes. Ana tjetër ka të bëjë me konkluzionin që del nga *Grafiku 1*, sipas të cilit institucionet qendrore janë karakterizuar nga një tendencë shpërfillëse ndaj legjislacionit të shërbimit civil dhe minuese ndaj vendimarrjes së Komisionit të Shërbimit Civil, megjithëse ligji i detyron subjektet të zbatojnë vendimet e këtij institucioni. Ky konkluzion konvergjon edhe me konkluzionin e Raportit të Komisionit Europian. Po sipas këtij grafiku, mungesa e *sigurisë ligjore*, është shoqëruar me mungesën e planifikimit të karrierës dhe menaxhimit të performancës në shërbimin civil dhe emërimet politike.

**Grafiku 1. Numri i vendimeve të pazbatuara të Komisionit të Shërbimit Civil në Institucionet Qendrore për periudhën Janar – Tetor 2006**



*Burimi: Komisioni i Shërbimit Civil, të dhëna statistikore të vitit 2006.*

Listën e moszbatimit të vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil e kryesojnë Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. I vetmi institucion qendror që e ka kryer procesin e ristrukturimit në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil paraqitet Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Të dhënat e nxjerra nga dokumentacioni zyrtar i Komisionit të Shërbimit Civil, dëshmojnë se më shumë se 70% e ankesave të individëve të cilët janë prekur nga ristrukturimi i administratës publike, janë pranuar nga ky komision. Fakti që ky numër i madh shkarkimesh është konsideruar në kundërshtim me ligjin nga Komisioni i Shërbimit Civil, tregon se procesi i ristrukturimit është udhëhequr nga konsiderata joligjore që nuk kanë të bëjnë me sistemin e karrierës dhe profesionalizmit dhe se Departamenti i Administratës Publike është treguar i paafte në menaxhimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e meritës dhe karrierës, dhe në disa raste ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Nëpërkëmbja e legjislacionit nga ana e institucioneve të sipërpërmendura dhe e Departamentit të Administratës Publike, sjell pasoja financiare të cilat do të duhen të përballohen nga taksapaguesit shqiptarë, pasi për një vend pune paguhen dy, ose tre persona.

Duket se anashkalimi i fuqizimit të administratës publike në përputhje me kriterin e Madridit dhe zëvendësimi i tyre me strukturat horizontale të cilat punojnë nën varësinë direkte të Kryeministrit, nuk kanë qenë aq efektive. Madje, Raporti nuk nguron të verë në dukje tendencat centralizuese të pushtetit, ku shumë vendime merren nga Kryeministri, gjë që është shoqëruar me vonesa në aksionet kyçe. Praktika sugjeron se, një përfshirje sa më e madhe e Kryeministrit në lidhje me zbatimin e detyrimeve që lindin nga procesi i integritit evropian, është e nevojshme, porse kjo përfshirje rezulton më efektive kur shfaqet në raport të drejtë me fuqizimin e kapaciteteve administrative, si memorija institucionale e procesit.

#### 4. SFIDA E NDËRTIMIT TË NJË SISTEMI GJYQËSOR EFIÇENT NË MUNGESË TË NJË STANDARDI TË UNFIKUAR EUROPIAN

Avokati dhe politikani i njohur Spartak Ngjela në librin e tij botuar së fundmi *“Reformë Shqiptare, shmangia e karakterit tiranik të politikës”*, analizon në mënyrë të hollësishme shtyllat e funksionimit real të demokracisë liberale dhe të kapitalizmit, të tilla si kushtetutshmëria, parlamentarizmi, tregu, zgjedhjet e lira dhe pushteti gjyqësor. Z. Ngjela, e përshkruan pushtetin gjyqësor si jo funksional sepse *“ai nuk është i pavarur, madje ai është edhe pa personalitet dhe ende nuk mund të thuash se i përmbush dot të gjitha detyrat që duhet të kryejë në sistemin e një demokracie liberale”*<sup>7</sup>.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të sistemit gjyqësor, është analizuar në Raport duke nënvizuar iniciativat e vetë Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të mënjanuar konfliktin e interesit, rritjen e transparencës së sistemit gjyqësor dhe zgjerimin e programeve trainuese për magistratët e rinj. Megjithatë procedurat gjyqësore vazhdojnë të mbeten të gjata e shpesh të paqarta. Pavarësia e gjyqtarëve është ende e rrezikuar dhe trajtimi financiar është i pamjaftueshëm. Për pasojë sistemi i drejtësisë ka nevojë t’i nënshtrohet reformave të vazhdueshme të cilat janë vendimtare për zhvillimin e vendit, garanci për zbatimin e MSA-së dhe shtysë për procesin e integritimit evropian.

Në këtë kuadër, është e rëndësishme që projekt-ligji i miratuar në Këshillin e Ministrave gjatë diskutimit në Kuvend të adresojë plotësisht tri aspekte, të nënvizuara edhe nga Raporti i Komisionit Evropian:

- rritjen e pavarësisë dhe mbrojtjen kushtetuese të gjyqtarëve;
- rritjen e pagave dhe statusit të stafit administrativ të sistemit gjyqësor;
- eliminimin e dublimit midis inspektoriateve gjyqësore të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë.

BE e cila mbështetet mbi një korpus vlerash, ligjesh, standardesh dhe institucionesh demokratike, të frymëzuara nga traditat kushtetuese të vendeve anëtare, evidenton në dokumentet ligjore dhe strategjitë e saj, rolin e pazëvendësueshëm që luan sistemi i drejtësisë në përgjithësi dhe pushteti gjyqësor në veçanti për mbrojtjen dhe pasurimin e këtyre vlerave<sup>8</sup>.

Standarde të unifikuara europiane të reformës në gjyqësor janë të vështira për t’u identifikuar në rrafshin komunitar. Madje vetë Komisioni Evropian, në disa raste, ka rekomanduar qasje të ndryshme për të njëjtën çështje. Për shembull, Komisioni i ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme Sllovakisë të hiqte periudhën e stazhit për gjyqtarët, ndërkohë që ka inkurajuar Slloveninë të parashikonte një periudhë stazhi pesëvjeçare për gjyqtarët e saj<sup>9</sup>.

Megjithatë, ekzistojnë disa standarde të pranura gjerësisht, të cilat duke duke përbërë një emërues të përbashkët të shteteve anëtare të BE-së, ndikojnë në procesin e reformës gjyqësore në shtetet që aspirojnë anëtarësimin në BE, gjithsesi duke i lënë këtyre te fundit një hapësirë veprimi dhe zgjedhjeje. Komisioni Evropian edhe pse me qasje të ndryshme i ka

---

<sup>7</sup> Shih, Spartak Ngjela, *Reformë Shqiptare, shmangia e karakterit tiranik të politikës*, fq. 219, (2006).

<sup>8</sup> Shih, European Commission Strategy Paper, 2001 në [www.eumap.org](http://www.eumap.org).

<sup>9</sup> Shih, *Monitoring the EU Accession Process – Judicial Capacity*, fq. 20, shkurt 2002 në [www.eumap.org](http://www.eumap.org).

përdorur këto standarde për të monitoruar reformat në gjyqësor. Këto standarde mund të përmbliidhen në detyrimin e çdo shteti për të siguruar *një gjyqësor të pavarur dhe të aftë*.

Duhet pasur kujdes që të mos abuzohet me petkun e pavarësisë nga ana e vetë gjyqësorit. Adresimi i perceptimit negativ që ushqen opinionin publik ndaj performancës së gjyqësorit mund të realizohet vetëm nëpërmjet një rruge të mundimshme reformash të cilat, në rastin e Shqipërisë, duhen filluar që nga edukimi ligjor dhe formimi profesional i gjyqtarëve dhe prokurorëve i cili, paraqitet defektoz, në raport me sfidat e zhvillimit të vendit. Mungesa e *sigurisë ligjore* nga e cila karakterizohet jeta publike në Shqipëri, mund të ridimensionohet vetëm nëpërmjet forcimit të sistemit të drejtësisë<sup>10</sup>.

## 5. POLITIKA ANTIKORRUPSION NUK DUHET KTHYER QËLLIM NË VETVETE

Lufta ndaj korrupsionit dhe retorika populiste që ka shoqëruar shpesh këtë proces, krahas arritjeve, ka krijuar një perceptim të rremë sipas të cilit procesi i afrimit të Shqipërisë me BE, është i lidhur kryesisht me progresin në luftën ndaj korrupsionit. Lufta ndaj fenomeneve të korrupsionit ka qenë dhe vazhdon të mbetet një ndër prioritetet kryesore për Shqipërinë, në funksion të zhvillimit ekonomik dhe institucional të vendit si dhe për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit europian. Në këtë kuadër, Raporti i Komisionit Europian shpreh vlerësime në lidhje me progresin e shënuar, sikundër nënvizon ndërhyrjet efikase të institucioneve të pavarura në rastet kur politika antikorrupsion është zhvilluar jashtë kornizave kushtetuese.

Njësia matëse e përdorur nga Komisioni Europian në lidhje me progresin e shënuar në politikën antikorrupsion janë vendimet e gjyqësorit çka, në një farë mënyrë, deligitimon çdo lloj tendence për ta shndërruar luftën antikorrupsion në qëllim në vetvete. Kështu, gjatë vitit 2004 janë ndëshkuar 171 persona, ndërsa gjatë vitit 2005 janë ndëshkuar 237 të tillë. Numri i procedimeve disiplinore kundër prokurorëve të korruptuar, është një tjetër tregues i hapave që po ndërmerren në funksion të luftës ndaj korrupsionit. Gjithashtu, Raporti vlerëson uljen e korrupsionit në shërbimet tatimore dhe doganore, reformat në funksion të pakësimit të rolit të shtetit në jetën ekonomike dhe sociale të vendit, sikundër thjeshtimin e procedurave administrative dhe liçensuese.

Mirëpo, fenomeni i korrupsionit, shfaqet i ndryshëm në varësi të zhvillimit të vendit. Në vendet e zhvilluara korrupsioni identifikohet në rastet *individuale*, si pasojë e shkeljes së normave të integritetit<sup>11</sup>. Ndërsa në vendet në zhvillim korrupsioni nënkupton *partikularizmin*<sup>12</sup> – një model i organizimit social, i cili karakterizohet nga shpërndarja e të ardhurave publike në mënyrë jouniversale, çka pasqyrohet në shpërndarjen vicioze të pushtetit në këto shoqëri.

<sup>10</sup> Shih, gjithashtu për këtë argument, Spartak Ngjela, *Reformë Shqiptare, shmangia e karakterit tiranik të politikës*, fq. 219-220, i cili e përcakton gjyqin si “epiqendra e ruajtjes së pacenuar të personalitetit njerëzor dhe të vetë sistemit”.

<sup>11</sup> Shih, Alina Mungiu-Pippidi, *Corruption: Diagnosis and Treatment*, Journal of Democracy, Volume 17, No. 3, July 2006.

<sup>12</sup> Shih, Guillermo O'Donnell, *Illusions about Consolidation*, in Larry Diamond, Marc F. Plattner, Yunhan Chu, and Hung-mao Tien, eds., *Consolidating the Third Wave Democracies* (Baltimore: Johns Hopkins University Press, 1997), 45-47.

Shumë pak fushata antikorrupsion guxojnë të sulmojnë rrënjët e korrupsionit në shoqëritë ku partikularizmi është kthyer në normë, pasi rrënjët e fenomenit e kanë zanafillën e vërtetë tek pushteti në vetvete. Në të kundërt, strategjitë antikorrupsion miratohen dhe zbatohen në bashkëpunim me *predatorët* të cilët kontrollojnë, jo vetëm qeverinë, por edhe instrumentët e antikorrupsionit<sup>13</sup>.

Në një shoqëri si kjo e jona ku elementët e partikularizimit dominojnë skenën publike, lufta ndaj korrupsionit kërkon një përmirësim dhe zbatim efektiv të kuadrit ligjor, në mënyrë që të jetë e vërtetë, efektive, në përputhje me parimet kushtetuese dhe në funksion të zhvillimit e modernizimit të vendit. Çështje më e rëndësishme, lufta kundër korrupsionit kërkon një qasje të re politike, bashkëveprim, kontroll të ndërsjelltë e strategji të bashkërenduara të aktorëve të ndryshëm, e mbi të gjitha një qeverisje që i paraprin plagëve kryesore nga të cilat buron korrupsioni dhe krimi. Kjo arrihet nëpërmjet reformave politike, ligjore, ekonomike dhe sociale, sikundër nëpërmjet ndërtimit të një sistemi drejtësie mbi baza thellësisht ligjore e profesionale.

## **6. KONKURRUESHMËRIA DHE RRIËTJA E QËNDRUESHME EKONOMIKE**

Në diskutimet në lidhje me kriteret e anëtarimit në BE shpesh konfliktualiteti politik, retorika dhe mungesa e njohjes së procesit, eklipsojnë debatin e vërtetë në lidhje me konkurrueshmërinë dhe zhvillimin e ekonomisë shqiptare, a thua se procesi i integritimit europian nuk ka përjasje ekonomike, e për më tepër, lidhje me zhvillimin dhe transformimin e vendit<sup>14</sup>.

Përsa i përket kriterit ekonomik, Raporti analizon politikën monetare të kujdesshme të ndjekur nga Shqipëria, në përputhje me rekomadimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, klimën markoekonomike të shëndoshë, e cila është karakterizuar nga një rritje e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Kjo rritje duket se kërcënohet seriozisht, ashtu si edhe i gjithë zhvillimi i vendit, nga kriza energjitike, faktor që ndikon direkt mbi ekonominë dhe biznesin e vendit.

Sikurse evidenton *Tabela 1*, Prodhimi i Brendshëm Bruto i Shqipërisë, me gjithë rritjen e vazhdueshme, paraqitet ende i ulët në raport me mesataren e PBB-së për frymë të vetë BE-së (19%), apo dhe në raport me PBB e vendeve që u anëtaruan në BE në vitin 2004 (29%). PBB i Shqipërisë është më i ulët edhe se PBB e Bullgarisë dhe Rumanisë që do të anëtarsohen më 1 Janar 2007 (47%), apo e Kroacisë dhe Turqisë që janë në procesin e negociimit për anëtarim me BE-në (47%) ashtu si edhe me mesataren e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor (74%).

---

<sup>13</sup> Shih, Alina Mungiu-Pippidi, *Corruption: Diagnosis and Treatment*, Journal of Democracy, Volume 17, No. 3, July 2006.

<sup>14</sup> Në lidhje me plotësimin e kriterit ekonomik, shih, *Just what is this 'absorption capacity' of the European Union?*, Policy Brief No. 113, Center for European Policy Studies, në [www.ceps.be](http://www.ceps.be).

**Tabela 1. Prodhimi i Brendshëm Bruto i Shqipërisë krahasuar me vendet e BE-së, Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë**

PBB për frymë Shqipëria	%
PBB për frymë krahasuar me mesataren e BE-25	19%
PBB për frymë krahasuar me mesataren e vendeve që u antarësuan në BE në 2004	29%
PBB për frymë krahasuar me mesataren e Bullgarisë dhe Rumanisë	47%
PBB për frymë krahasuar me mesataren e Kroacisë dhe Turqisë	47%
PBB për frymë krahasuar me mesataren e vendeve të Ballkanit Perëndimor	74%

Burimi: Faqja zyrtare e Komisionit European ([www.ec.europa.eu](http://www.ec.europa.eu))

Debati në lidhje me rritjen e PBB-së vazhdon të zhvillohet me intensitet edhe në vendet e anëtaruara rishtazi në BE, ku projeksionet tregojnë se në vitin 2014 Republika Çeke do të arrijë 74% të mesatares së PBB-së të BE-së me 15 vende anëtare, ndërkohë, Hungaria rreth 69.1%, Polonia rreth 56.8%, Rumania rreth 47%, Sllovenia rreth 82.1% dhe Turqia rreth 45.8%<sup>15</sup>. Pra, Shqipëria ka një rrugë të gjatë përpara, sidomos në lidhje me zhvillimin dhe integrimin ekonomik në BE.

Remitancat llogariten në rreth 14.6 % të PBB-së për vitin 2005, rreth 19 % më shumë se në vitin 2004, duke u kthyer kështu në një burim relativisht të qëndrueshëm të ardhurash, por duke dëshmuar në të njëjtën kohë se, ekonomia shqiptare vazhdon të mbështetet në një masë relativisht të madhe nga remitancat. Të ardhurat nga remitancat duhen analizuar dhe lexuar ngushtë me marrëveshjet e ripranimit që Shqipëria ka nënshkruar me Komunitetin European dhe me shumicën e shteteve anëtare të BE-së, të cilat përcaktojnë rregullat dhe procedurat e kthimit të shtetasve që qëndrojnë në mënyrë të parregullt në hapësirën komunitare.

Nga ana tjetër, këto marrëveshje si dhe masa të tjera të ndërmarra nga shtetet anëtare të BE, synojnë të përmirësojnë procesin e integritit të shtetasve shqiptare që jetojnë në hapësirën komunitare. Për pasojë, integrimi i mëtejshëm mund të shoqërohet me uljen e kontributit për remitancat. Për këtë arsye ekonomia shqiptare duhet të fillojë të mendojë seriozisht për alternativa të tjera, duke zvogëluar gradualisht varësinë nga remitancat.

Ndërkohë, klima e biznesit sipas Raportit të Komisionit European, shfaqet e pasigurtë dhe e paqartë, pasi zhvillohet në mungesë të parimit të *sigurisë ligjore*. Procesi i kthimit dhe kompensimit të pronës mbetet i ngadaltë, duke mos shërbyer si një bazë e shëndoshë për zhvillimin e një ekonomie ku konkurrenca e lirë dhe e drejta e pronës respektohen.

Ndërtimi i një baze të fortë makroekonomike nuk është e mjaftueshme për sigurimin e rritjes ekonomike. Sipas Hernando de Soto, një rëndësi të madhe në procesin e rritjes ekonomike ka respektimi i të drejtës së pronës<sup>16</sup>. Një mjedis i dobët në lidhje me të drejtën e pronës, kontribuon në shkurajimin e investimeve, në pasiguri dhe komplikime në lidhje me

<sup>15</sup> Shih, D. Gros and A. Steinherr, *Economic Transition in Central and Eastern Europe*, 2nd edition, chapter 9, Cambridge: Cambridge University Press, 2004.

<sup>16</sup> Shih, World Economic Forum, *The Global Competitiveness Index: Identifying the Key Elements of Sustainable Growth*, p. 4 (2006).

planifikimin afatgjatë, të shoqëruara këto me probleme në efikasitetin e sistemit gjyqësor, të cilat nuk inkurajojnë një klimë të shëndetshme dhe të ndershme biznesi të bazuar në drejtësi.

Hapat pozitivë të ndërmarra në lidhje me reduktimin e barrierave administrative, zvogëlimin e kohës mesatare për regjistrimin e biznesit nga 30 në 8 ditë, duhen shoqëruar me reforma të cilat duhet të adresojnë sfidat në lidhje me koston relativisht të lartë për hapjen dhe mbylljen e një biznesi, dokumentacionin e kufizuar kadastral, përqindjen ende të lartë të ekonomisë informale dhe performancën e administratës publike.

Konkurrueshmëria, si shtysë për rritjen dhe qëndrueshmërinë ekonomike, duhet parë ngushtë me nivelin e produktivitetit, rritjen e eksporteve dhe krijimin e një mjedisi institucional<sup>17</sup>, i cili karakterizohet nga qëndrueshmëria politike, hapja dhe transparencja në menaxhimin e burimeve publike, nga një sistem transparent gjyqësor që operon në përputhje me ligjin si dhe një kuadër rregullator i zhdërvjelltë për biznesin<sup>18</sup>.

Për fat të keq, gjithnjë e më pak, debati publik në Shqipëri fokusohet në shkollimin profesional dhe krijimin e një force pune të trainuar, e aftë për të përqaftuar teknologjitë e fundit. Axhenda e Lisbonës, e cila synon në kthimin e Europës në rajonin më konkurrues në botë deri në vitin 2010, nënvizon rëndësinë që kanë tregjet efikente të punës si një nga parakushtet për rritjen e produktivitetit<sup>19</sup>.

## **7. A REFLEKTOHEN PRIORITETET E MSA NË ZËRA BUXHETORË?**

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Përkohshme më 1 Dhjetor 2006, u shoqërua me një konfuzion mediatik, sipas të cilit, kjo marrëveshje shënon vendosjen e zonës së tregtisë së lirë. Në fakt, një ndër qëllimet e marrëveshjes është vendosja gradualisht e zonës së tregtisë së lirë, gjatë një periudhe maksimumi dhjetëvjeçare, duke filluar nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshje<sup>20</sup>.

Bashkimi Europian i ka ofruar Shqipërisë në vitin 1999 Sistemin e Përgjithshëm të Preferencave, sipas të cilit u vendos një regjim liberalizues tregtar vetëm nga ana e BE-së, ndërkohë që Shqipërisë, për të përfituar nga ky regjim i kërkohej përmbushja e disa standardeve<sup>21</sup>. Bazuar në Rregulloren 2007/2000, BE-ja i ofroi Shqipërisë një regjim autonom preferencial, nëpërmjet plotësimit të konceptit të origjinës së produktit dhe krijimit të një zone të tregtisë së lirë, midis vendeve të përfshira në procesin e Stabilizim Asociimit.

---

<sup>17</sup> Shih, Daniel Kaufmann (2005), Drejtor i Programeve Globale në Institutin e Bankës Botërore, Indeksi Botëror i Konkurrueshmërisë, World Economic Forum (2006).

<sup>18</sup> Sipas Indeksit Botëror të Konkurrueshmërisë, shtytësit e produktivitetit dhe të konkurrueshmërisë janë të grupuar në shtylla ku përfshihen *kërkesat bazë* të tilla si institucionet, infrastruktura, makroekonomia dhe shëndeti dhe arsimit fillor; *rritësit e efikasitetit* të tilla si arsimit i lartë dhe trajnimi, si edhe efikasiteti i tregjeve; dhe nënindeksi i fundit *inovacioni dhe faktorët e sofistikimit* të tillë si zgjuarsia teknologjike, sofistikimi i biznesit dhe inovacioni.

<sup>19</sup> Shih, Axhendën e Lisbonës 2004 tek [www.ec.europa.eu](http://www.ec.europa.eu).


<sup>20</sup> Shih, Nenin 3 të Marrëveshjes së Përkohshme.

<sup>21</sup> Shih, Rregulloret e Këshillit të BE-së 1763/99 dhe 2820/98.

Pavarësisht incentivave europiane, niveli i eksporteve shqiptare në drejtim të hapësirës komunitare është ende i ulët, duke dëshmuar se çdo incentiv i ofruar nga BE-ja duhet shoqëruar me krijimin e infrastrukturës së tregut dhe standardeve. Në këtë kuadër duhet lexuar Raporti i Komisionit European, sipas të cilit, në shumicën e fushave të tilla si prokurimet publike, pronësia intelektuale dhe industriale, mbikqyrja e tregut, siguria ushqimore, metrologjia dhe kalibrimi, çështjet veterinare dhe fitosanitare, mjedisi, mbrojtja e të dhënave personale, nuk vërehet progres substancial.

Kjo situatë jo e favorshme në rast se nuk adresohet me përparësi, nuk i krijon mundësi subjekteve për të nxjerrë përfitimet e pritshme nga marrëveshja. Për fat të keq, buxheti i shtetit i porsamiratur, (shih Grafikun 2) nuk orientohet për nga prioritetet e MSA-së, duke humbur shansin e krijimit gradual dhe në mënyrë strategjike të kushteve për të përfituar nga mundësitë që ofrojnë standardet europiane të reflektuara në MSA.

**Grafiku 2. Shpërndarja e Buxhetit të Shtetit 2007 sipas Ministrive dhe Institucioneve**




*Burimi: Ministria e Financave, Paketa e Buxhetit të Shtetit 2007*

*Pesha e shpenzimeve buxhetore të çdo institucioni është llogaritur si raport i buxhetit të institucionit përkatës mbi totalin e buxhetit.*

Ky Grafik dëshmon për një ndarje jo të balancuar të buxhetit të shtetit më një diferencë të madhe midis Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, si institucioni më i financuar, duke zënë 20.57% të buxhetit dhe Ministrisë së Integritit European, si institucioni më pak i financuar, duke zënë vetëm 0.06% të buxhetit, pavarësisht se detyrat dhe funksionet që ajo duhet të luajë vijnë gjithnjë në rritje si bashkërenduese e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritit european të vendit<sup>22</sup>.

Duke lënë mënjanë koinçidencën ironike të faktit se Ministria e Integritit European në periudhën pas nënshkrimit të MSA-së, paraqitet si ministria më pak e financuar, Grafiku 3 evidenton një përgjysmim të peshës së buxhetit të Ministrisë së Integritit European në krahasim me vitin 2005, dhe një rënie prej 21% të kësaj peshe në krahasim me vitin 2006.

**Grafiku 3. Tendenca tre vjecare e buxhetit të Ministrisë së Integritit European 2005-2007**



*Burimi: Ministria e Financave, Paketa e Buxhetit të Shtetit 2007.*

<sup>22</sup> Shih, Vendimin Nr. 580, datë 10.09.2004 "Për fushën e veprimtarisë së Ministrisë së Integritit European".

	2005	2006	2007
Buxheti i Ministrisë së Integritimit European (në mijë lekë)	190,000.00	116,125.00	115,000.00
Pesha e Buxhetit të MIE ndaj Totalit të Buxhetit Ministror dhe Institucional	0.12%	0.075%	0.06%

Pse ky përgjysmim buxhetor për Ministrinë e Integritimit European? A e ka përfunduar misionin e vet ky institucion, apo mungon vizioni politik për ta bërë atë të zëshëm?

Përkundër interpretimit mekanik se me nënshkrimin e MSA-së dhe krijimin e njësisve të integritimit european në institucionet e linjës, roli i Ministrisë së Integritimit European duhet zbehur, roli i këtij institucioni, pavarësisht vendosjes në hirearkinë institucionale, e cila në variantin më të mirë nuk duhej të ishte një nga ministritë e linjës, por një strukturë qendrore në Këshillin e Ministrave në varësinë direkte të Kryeministrit, duhet të rritet në funksion të procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis communautaire*, monitorimit të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i MSA-së, bashkërendimit dhe përthithjes të asistencës komunitare, si mbështetëse e prioritetëve të Partneritetit European, MSA-së dhe rrjedhimisht zhvillimit të vendit.

Po kaq i rëndësishëm për këtë institucion mbetet bashkërendimi dhe sigurimi i procesit voluminoz të përkthimit të *acquis communautaire* në gjuhën shqipe, procesi i informimit dhe komunikimit të të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja për grupet e ndryshme të interesit, bashkëpunimi me pushtetin vendor, komunitetin dhe qytetarët. Në të njëjtën kohë, në përputhje me kriterin e Madridit, Ministria e Integritimit European duhet të bëhet promotore e ndërtimit të kapaciteteve administrative, nëpërmjet rekrutimit të stafëve të specializuara në universitete dhe institute prestigjioze, por edhe parashikimit të skemave të vazhdueshme të trajnimeve.

Hyrja në fuqi e MSA-së do të shoqërohet me ngritjen e disa strukturave të përbashkëta BE-Shqipëri, të cilat domosdoshmërisht duhen koordinuar nga Ministria e Integritimit European. Hyrja në fuqi e MSA-së imponon ngritjen e strukturave shqiptare të përhershme apo *ad hoc*, të cilat gjithashtu duhen koordinuar nga Ministria e Integritimit European. Natyrisht, struktura e re e Ministrisë së Integritimit European, mungesa e vizionit politik, kapaciteteve administrative dhe pesha e papërfillshme buxhetore që zë (0.06%) nuk ndihmojnë këtë institucion të përmbushë detyrimet që i ngarkon kuadri ligjor në fuqi.

Po në rast se roli i strukturës koordinuese të procesit duhet zbehur, meqë “topi” kalon në fushën e institucioneve të linjës, si paraqitet financimi i tyre në përputhje me prioritetet e MSA-së?

Buxheti i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës - një institucion kyç për administrimin e pjesës kryesore të detyrimeve që lindin nga Marrëveshja e Përkohshme në fushën e tregut – zë vetëm 1.38% të buxhetit të shtetit. Buxheti i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit zë vetëm 2.76% të buxhetit të shtetit, pavarësisht se ky institucion duhet të luajë një rol të qenësishëm në procesin e adoptimit të standardeve europiane të cilat janë voluminoze në rastin e fushave që mbulohen nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave zë vetëm 0.94% të buxhetit të shtetit, duke e bërë thujse të pamundur zbatimin gradual të standardeve europiane në fushën e mjedisit. Aq më tepër po

të marrim parasysh faktin se përmbushja e standardeve në fushën e mjedisit shoqërohet me kosto të larta financiare.

*Tabela 2* përmbledh disa nga fushat prioritare të lidhura direkt me MSA-në. Disa nga këto zëra janë elementë të detajimit të buxheteve ministeriale dhe për këtë arsye rëndësia e tyre është parë e lidhur me buxhetin e ministrisë përkatëse. Kolona e dytë përlllogarit peshën e këtyre aktiviteteve në krahasim me buxhetin total të Ministrive dhe Institucioneve.

*Tabela 2. Zërat e Buxhetit të Shtetit sipas Institucioneve 2007*

INSTITUCIONI	TOTALI I BUXHETUAR (në mijë lekë)	PESHA NDAJ BUXHETEVE INSTITUCIONALE	PESHA E INSTITUCIONIT NDAJ TOTALIT TË PËRGJITHSHËM TË SHPENZIMEVE TË BUXHETIT 2006
Shërbimi i Prokurimit Publik	26.508,00	4%	0,01%
<b>Këshilli Ministrave</b>	<b>612.000,00</b>		0,31%
			0,00%
Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	1.660.450,00	61%	0,85%
Shërbimet e Tregut, Akreditim dhe Inspektim	159.090,00	6%	0,08%
<b>Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës</b>	<b>2.706.150,00</b>		1,38%
			0,00%
Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit	1.337.961,00	25%	0,68%
Mbështetja e Prodhimeve Bujqësore, Blektorale, Agroindustriale dhe Marketingut	978.100,00	18%	0,50%
Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	159.500,00	3%	0,08%
<b>Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit</b>	<b>5.415.970,00</b>		2,76%
			0,00%
<b>Prokuroria e Përgjithshme</b>	<b>961.000,00</b>		0,49%
<b>Gjykata Kushtetuese</b>	<b>91.000,00</b>		0,05%
<b>Drejtoria e Përgjithshme e Doganave</b>	<b>1.255.000,00</b>		0,64%
<b>Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit</b>	<b>26.000,00</b>		0,01%
<b>Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve</b>	<b>1.598.000,00</b>		0,82%
<b>Drejtoria e Metrologjisë dhe Kalibrimit</b>	<b>24.000,00</b>		0,01%
<b>Shkolla e Magjistraturës</b>	<b>53.000,00</b>		0,03%
<b>Këshilli i Lartë i Drejtësisë</b>	<b>65.000,00</b>		0,03%
<b>Autoriteti i Konkurrencës</b>	<b>51.000,00</b>		0,03%
			0,00%
Drejtësia dhe Tregu i Brendshëm	29.270,00	25%	0,01%
Mbështetja Institucionale për Procesin e Integritimit	23.810,00	21%	0,01%
<b>Ministria e Integritimit</b>	<b>115.000,00</b>		0,06%
<b>TOTALI I BUXHETUAR 2007</b>			<b>195.973.018</b>

*Burimi: Ministria e Financave, Paketa e Buxhetit të Shtetit 2007*

Po të analizojmë fondet e alokuara dhe strukturën administrative, përkundrejt detyrimeve apo mundësisë së përfitimeve të ofruara nga MSA-ja, për shembull, në fushën e veterinarisë dhe implikimet e saj në treg, evidentohet qartë se, fondet e alokuara janë të pamjaftueshme për të ngritur një strukturë të përshtatshme e cila do të garantonte pjesën më të madhe të sigurisë në zinxhirin e prodhimit të produkteve dhe nënprodukteve ushqimore me origjinë shtazore. Kjo mangësi administrative dënon prodhuesit vendas, duke bërë të pamundur rritjen e eksporteve drejt BE-së të mundësuar nga liberalizimi i ofruar nga MSA-ja.

Edhe sikur në plan të parë të analizës të vendosnim sigurimin e të ardhurave nga ky sektor (*prodhimi i produkteve dhe nënprodukteve ushqimore me origjinë shtazore*), sërish struktura e kontrollit veterinar sipas modelit komunitar, do të siguronte të ardhura të mjaftueshme, që do t'i lejonin qeverisë të kryente vetëm një investim fillestar. Në vitet në vijim kjo strukturë, përveç garantimit të prodhimit, si për konsum të brendshëm, ashtu dhe për eksportim në vendet e BE-së, do të vetëplotësonte fondet e nevojshme për funksionimin e saj.

E njëjta gjë mund të thuhet në lidhje me buxhetin e alokuar në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës për mbikqyrjen e tregut, akreditimin dhe inspektimin, kur vetë strukturat e mbikqyrjes së tregut, inspektimi dhe aksesimi për të gjithë konsumatorët ende nuk ekzistojnë. Reformat në fushën e tregut, pavarësisht vështirësive, duhet të fillojnë me shpejtësi, në rast se duam t'i japim ekonomisë shqiptare një dinamikë të re zhvillimi.

Po kështu, buxheti i alokuar për prokurimet publike mbetet i ulët, pavarësisht se progresi në këtë fushë është jetik për përmirësimin e qeverisjes së sektorit publik dhe hapjen e këtij sektori ndaj ofertave konkurruese. Por, në fushën e prokurimeve publike, mungesa e buxhetit është vetëm një nga problematikat e shumta krahas mungesës së kapaciteteve administrative në Agjencinë e Prokurimeve Publike, vazhdimin me intensitet të tenderimeve të drejtpërdrejta dhe mungesës së konkurrencës.

Për më tepër, projektligjit për prokurimet publike që u miratua në parim në Kuvend i mungon *garancia*, pasi nuk parashikon krijimin e një organi të pavarur me fuqi vendimarrëse për shqyrtimin e ankesave dhe procedurave të tenderimit, anëtarët e të cilit mund të zgjidheshin nga Kuvendi me 3/5 e votave në bazë të propozimeve nga institucione dhe grupe të ndryshme. Kjo mënyrë do të garantonte bazën konsensuale politike në Kuvend, pavarësinë dhe garancinë e qëndrimit në detyrë të anëtarve të këtij Komisioni ndaj çdo rotacioni politik, duke shmangur në të njëjtën kohë precedentin jo të suksesshëm të vendosur me konstituimin e Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit Shqiptar dhe Këshilli Drejtues i Radio Televizionit Shqiptar. Në të kundërt, krijimi i *Ombudsman-it* të prokurimeve<sup>23</sup>, i cili do të miratohet nga Kuvendi me propozim të Këshillit të Ministrave nuk mund të luajë të njëjtin rol që luan një autoritet i pavarur si për nga mënyra e zgjedhjes së tij ashtu dhe nga fuqitë vendimarrëse<sup>24</sup>.

Gjithashtu, pronësia intelektuale dhe industriale si prioritet të MSA-së nuk reflektohen si të tilla në buxhet. Përgjegjësitë e fragmentuara të aktorëve të ndryshëm qeveritar duhen adresuar, kapacitetet administrative duhen forcuar dhe gjyqtarët duhen specializuar. MSA-ja përcakton se brenda katër vjetësh Shqipëria do të sigurojë të njëjtën mbrojtje të pronësisë intelektuale dhe

<sup>23</sup> Shih, nenet 13, 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19 të projektligjit “Për prokurimin publik” i cili është miratuar në parim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

<sup>24</sup> Shih gjithashtu për këtë çështje, *Në kërkim të një axhende realiste për integrimin evropian të Shqipërisë*, Policy Brief 1 të Institutit AGENDA në [www.agendainstitute.org](http://www.agendainstitute.org).

industriale si në Komunitetin European. Në mënyrë që të sigurohet kjo mbrojtje, kërkohet një strategji e mirëpërcatuar e shoqëruar me një financim të përshtatshëm.

## 8. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- Procesi i integritit european të Shqipërisë kërkon një qasje pragmatiste ku mundësitë dhe sfidat e procesit duhen diskutuar në mënyrë të balancuar dhe neutrale. Përgjegjësia e qeverisjes në përfshirjen e aktorëve kryesorë dhe e opinionit publik në këtë debat të sinqertë, është e dukshme.
- Konsensusi politik dhe fryma bashkëpunuese midis aktorëve politik duhet të jetesohet nëpërmjet një axhende konkrete konsensuale, kryesisht në çështje që lidhen me reformën zgjedhore, zhvillimin ekonomik, institucional, tregun, sikundër reformimin e vazhdueshëm të sistemit gjyqësor, si çështje vendimtare për zhvillimin e vendit, garanci për zbatimin e MSA-së dhe shtysë për procesin e integritit european.
- Me gjithë rëndësinë që paraqet respektimi i standardeve zgjedhore dhe progresi në luftën ndaj korrupsionit, trafikëve dhe krimit të organizuar, procesi i integritit european nuk duhet barazuar vetëm me to. Perkundrazi, duhet shndërruar në një proces shumëpërmasorë zhvillimi, modernizimi dhe transformimi të vendit, në përputhje me standardet europiane të sanksionuara në *acquis communautaire*.
- Qeveria shqiptare duhet të punojë seriozisht për ndërtimin e kapaciteteve administrative në përputhje me kriterin e Madridit, nëpërmjet rekrutimit ligjor dhe transparent të stafeve të specializuara në universitete dhe institute prestigjioze, parashikimit të skemave të vazhdueshme të trajnimeve, zbatimit të legjislacionit mbi shërbimin civil, e me specifikisht, të vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil dhe Gjykatës së Apelit, si dhe vënies përpara përgjegjësisë të personave të cilët i kanë shkaktuar dëme buxhetit të shtetit nga nëpërkëmbja e legjislacionit mbi shërbimin civil.
- Për të siguruar një bashkërendim më të mirë të detyrimeve shumëpërmasore që burojnë nga ky proces, Ministria e Integritit European mund të shndërrohet në një strukturë në Këshillin e Ministrave në varësinë direkte të Kryeministrit, çka mund të garantonte ngjizje më të mirë të prioriteteve të procesit të integritit european me axhendën e zhvillimit të vendit. Por, në të njëjtën kohë, mund të siguronte një kontroll të përditshëm vertikal të Kryeministrit ndaj institucioneve të linjës, si dhe një raport më të drejtpërdrejt me Kuvendin, i cili në analizë të fundit pritet të përballlet më një volum të madh pune, për shkak të procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis communautaire*.
- Integrimi ekonomik i Shqipërisë duhet shikuar në përputhje me projeksionin e përbërësve të PBB shqiptar, si e vetmja mundësi reale për t'u afruar me mesataren e PPB-së së vendeve të BE-së. Ekonomia shqiptare duhet të fillojë të gjenerojë burime të tjera alternative, duke zvogëluar gradualisht varësinë nga remitancat, si dhe duke investuar më mirë burimet ekzistuese. Gjithashtu, konkurrueshmëria si shtysë për rritjen dhe qëndrueshmërinë ekonomike, duhet shikuar ngushtë me nivelin e produktivitetit, rritjen e eksporteve dhe krijimin e një mjedisi institucional, i cili karakterizohet nga qëndrueshmëria politike, hapja dhe transparenca në menaxhimin e

burimeve publike, një sistem transparent gjyqësor që operon në përputhje me ligjin dhe një kuadër rregullator i zhdërvjelltë për biznesin.

- Regjimi liberalizues i ofruar nga BE-ja nëpërmjet MSA-së rrezikon të mosprodhojë efektet e pritshme duke dënuar prodhuesit vendas dhe konsumatorët shqiptarë, duke mosrritur eksportet drejt BE-së dhe duke ulur në të njëjtën kohë besimin e opinionit publik në mundësitë e vërteta që ofron procesi i integritimit europian të Shqipërisë. Qeveria shqiptare duhet të ndërmarrë iniciativa ligjore, institucionale dhe buxhetore për zhvillimin e infrastrukturës së tregut, si e vetmja mundësi për zhvillimin dhe modernizimin e vendit, të cilat përkojnë me prioritetet e MSA-së, të tilla si: *siguria ushqimore, çështjet sanitare dhe fitosanitare, transporti, zhvillimi rural, prodhimi blegtoral, bujqësor dhe agropërpunimi, mjedisi, prokurimet publike, konkurrenca, ndihma shtetërore, doganat, tatimet, pronësia intelektuale dhe industriale, standardizimet dhe certifikimet, kalibrimi, mbrojtja e konsumatorit, mbikqyrja e tregut, përmirësimi i klimës së biznesit, legjislacioni mbi shoqëritë tregtare.*
- Në këtë kontekst, projektligji “Për prokurimin publik” që po diskutohet në Kuvend, duhet të reflektojë domosdoshmërisht detyrimet që rrjedhin nga Direktivat 2004/18/KE dhe 89/665/KEE, për ngritjen e një komisioni të pavarur shtetëror me fuqi vendimarrëse për të monitoruar, hetuar dhe shqyrtuar veprimet apo mosveprimet e paligjshme, ose të parregullta që shkaktohen nga autoritetet kontraktore. Për të siguruar *garantizimin*, anëtarët e këtij Komisioni duhet të zgjidhen nga Kuvendi me 3/5 e votave në bazë të propozimeve nga institucione dhe grupe të ndryshme. Kjo mënyrë do të garantonte bazën konsensuale politike në Kuvend, pavarësinë dhe garancinë e qëndrimit në detyrë të anëtarve të këtij Komisioni ndaj çdo rotacioni politik, duke shmangur në të njëjtën kohë precedentin jo të suksesshëm të vendosur me konstituimin e Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit Shqiptar dhe Këshilli Drejtues i Radio Televizionit Shqiptar.
- Buxheti i porsamiratur për vitin 2007 ka nevojë të ridimensionohet në përputhje me këto prioritete, të cilat janë esenciale për zhvillimin ekonomik dhe shfrytëzimin e oportuniteteve të ofruara nga MSA-ja. Përmirësimi i infrastrukturës fizike, simbolizuar në peshën buxhetore të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (20.57%), si institucioni më i financuar, duhet zhvilluar paralelisht dhe në mënyrë të harmonizuar me infrastrukturën e tregut. Më konkretisht, duhen shtuar kapacitetet administrative dhe fondet për institucione të tilla si: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës; Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit; Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.

## REFERENCA

*Report of the Commission of the European Communities*, COM (2006) 694 final, Brussels, 8.11.2006.

*Enlargement Strategy and Main Challenges 2006-2007*, COM (2006) 649, Brussels, 8.11.2006.

Konkluzionet e Këshillit Europian të datës 14-15 Dhjetor 2006.

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 29, datë 21.12.2006.

Spartak Ngjela, *Reformë Shqiptare, shmangia e karakterit tiranik të politikës*, (2006).

European Commission Strategy Paper, 2001 në [www.eumap.org](http://www.eumap.org).

*Monitoring the EU Accession Process – Judicial Capacity*, fq. 20, shkurt 2002 në [www.eumap.org](http://www.eumap.org).

Alina Mungiu-Pippidi, *Corruption: Diagnosis and Treatment*, Journal of Democracy, Volume 17, No. 3, July 2006.

Guillermo O'Donnell, *Illusions about Consolidation*, in Larry Diamond, Marc F. Plattner, Yunhan Chu, and Hung-mao Tien, eds., *Consolidating the Third Wave Democracies* (Baltimore: Johns Hopkins University Press, 1997), 45-47.

*Just what is this 'absorption capacity' of the European Union?*, Policy Brief No. 113, Center for European Policy Studies, në [www.ceps.be](http://www.ceps.be).

*Në kërkim të një axhende realiste për integrimin europian të Shqipërisë*, Policy Brief 1, Instituti AGENDA në [www.agendainstitute.org](http://www.agendainstitute.org).

D. Gros and A. Steinherr, *Economic Transition in Central and Eastern Europe*, 2nd edition, chapter 9, Cambridge: Cambridge University Press, 2004.

World Economic Forum, *The Global Competitiveness Index: Identifying the Key Elements of Sustainable Growth*, p. 4 (2006).

Axhenda e Lisbonës 2004 tek [www.ec.europa.eu](http://www.ec.europa.eu).

Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, Pë ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare”.

Rregulloret e Këshillit të BE-së 1763/99 dhe 2820/98.

Direktivat 2004/18/KE dhe 89/665/KEE.

Vendimi Nr. 580, datë 10.09.2004 “Për fushën e veprimtarisë së Ministrisë së Integritimit Europian”.

Projektligji “Për prokurimin publik”.

**Instituti AGENDA** është themeluar në vitin 2006 dhe është një organizatë *think tank* jofitimprurëse, e pavarur e cila operon në fushën e Mirëqeverisjes, Integritimit European dhe Politikave Europiane të Fqinjësisë, Politikave për Zhvillimin Social dhe Ekonomik.

### ***Misioni***

- Të inkurajojë dhe fuqizojë eksperiencat aktuale demokratike, duke promovuar vlerat demokratike gjatë proceseve të debatit, analizave dhe të implementimit të politikave publike në vend.
- Bërja e procesit të politikëbërjes më pak të politizuar, duke i ofruar politikëbërësve informacion kyç të bazuara në kërkime.

### ***Grupet e Interesit***

- Publiku
- Politikëbërësit
- Media
- Komuniteti i Biznesit

### ***Programet e Kërkimit***

- Mirëqeverisja
- Integrimi European dhe Politikave Europiane të Fqinjësisë
- Politikave për Zhvillimin Social dhe Ekonomik

### ***Policy Briefs***

*Policy Briefs* është një Cikël Analizash rreth politikave dhe strategjive kryesore publike të vendit, të përgatitura nga AGENDA Institute, me mbështetjen e Open Society Institute (OSI), Hungari

**Rr. Mustafa Matohiti, Nr. 4/3,  
Tirane, Shqiperi  
Tel/Fax: +355-4-258884  
Website: [www.agendainstitute.org](http://www.agendainstitute.org)  
E-mail: [info@agendainstitute.org](mailto:info@agendainstitute.org)**